



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:167038

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05660964

**NË EMËR TË POPULLIT**

**P.nr..../. .**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale kundër të pandehurit I.... H..... për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshme PP/II-nr.1490/22 të datës 04.08.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë ..... në prezencë të Prokurores së Shtetit Ardiana Veseli të pandehurit I.... H..... , të njëjtën ditë bie dhe shpalli publikisht, ndërsa me datë ..... përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri,**

**I..... H.....**, i lindur me dt. .... në Pejë, ku edhe banon në rr.”A.... B.... Q.....”, i biri e R.... dhe nënës M.... e gjinisë G...., me nr. personal ....., beqar, punëtor, i nacionalitetit Egjiptian, shtetas i R. Kosovës, mbrohet ne liri..

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

Me dt. .... rreth orës ...:.. në rr. “T..... T.....”-P....., pa autorizim posedon substanca narkotike dhe atë të llojit *Marihuanë*, në atë mënyrë që, përderisa i pandehuri ishte me biçikletën e tij ndalet afër lokalit frizer “T....” aty iu drejtohet të pranishmeve me fjalët “*a mund të ma ndezni një cigare*” ku aty polici E..... I.... i cili ishte në rroba civile ia ndezë cigaren dhe pastaj gjatë bisedës i pandehuri e pyet atë “*se a kërkon substanca narkotike*” i cili me pas e nxjerr një qese nga xhepi ku pastaj polici i prezantohet si person zyrtar me ç’rast i pandehuri tenton të largohet me biçikletë nga aty duke e hedhur substancën narkotike mirëpo ndalohet nga personi zyrtar.

-me çka ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të nenit 7, 17, 38, 39, 43,47, 48, 69, 70, 71 dhe 269 të KPRK-së, 7, 8 dhe 364 të KPPRK-së, të pandehurit Artan Gashi i shqipton:

### **DËNIM TË KUSHTËZUAR ME BURG DHE DËNIM ME GJOBË**

**Dënim me burgim** në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve, të cilin dënim i pandehuri nuk do të ta mbaj në rast se i njëjti në afat prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

**Dënim me gjobë** në shumë prej njëqind (100,00 €) euro, të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguaj në afat prej 1 (një) muaji, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 40 € (dyzet ) euro në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm ka ngrit aktakuzë aktakuzës PP/II.nr.951/22 të datës 30.05.20212 ndaj të pandehurit L... H..... për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Ne shqyrtimin fillestar të datës ..... gjykata ne pajtim me nenin 241 par. 1 të KPPRK-se e ka udhëzuar te pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaron për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe provueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Pasi i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta e leximit të aktakuzës gjykata është bindur se i pandehurit e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk kanë nevojë për sqarime shtesë. Me pas gjykata e ka njoftuar te pandehurin për pasojat dhe benefitet e pranimi te fajësisë.

I pandehuri A.... G..... është deklaruar fajtor për veprat penale sipas aktakuzës, duke shtuar se , jam penduar dhe shton se është e vërtetë që e kam kryer këtë vepër dhe premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet të këtilla.

Në vlerësimin e pranimi te fajësisë nga ana e te pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit te Shtetit i cili ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, i njëjti pranim është bere ne mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe po ashtu gjen mbështetje ne shkresat e lëndës.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se ne seancën e shqyrtimit fillestar nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 248 par. 1 pika 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPPRK-se, si dhe janë vërtetuar faktet nga neni 242 par. 6 të KPRK-se, ngase aktakuza mbështet në këto prova siç janë: Raporti i policit E..... I.... #10744 i dt. 25.06.2022; Raporti i policit F..... T..... #2491 i dt. 25.06.2022; Raporti i oficerit G..... D..... #10849 i dt. 25.06.2022; Procesverbali i marrjes në pyetje i të dyshuarit I..... H..... i dhënë në st. policor me dt. 25.06.2022; Fotografitë e letrave për pësjtjelljen e substancës narkotike Raporti informues i policit A..... K..... #6419 i dt. 25.06.2022; Deklarata e dëshmitarit E..... I.... e dhënë në Prokurori me dt.03.08.2022; Deklarata e te pandehurit e dhënë ne Procedurën paraprake pranë kësaj Prokurorie me dt.03.08.2022; CD-ja ; andaj ka marr aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili mbështet në provat në baze të se cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni 296 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën, gjykata mori pranimin e fajësisë. keq ardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata ka gjetur shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi si dënimi me gjobë dhe duke i tërhequr e vërejtjen me kërcënimin e dënimit të kushtëzuar me burgim dhe me gjobë, mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, gjykata i obligoi të akuzuarin që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë për paushallit gjyqësor në shumë prej 20,00 € dhe për taksen për programin për kompensimin e viktimave të krimit 20,00 €.

Konform nenit 269 par 3 të KPRK-se gjykata te akuzuarit i ka konfiskuar substancën narkotike e llojit marihuan.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL  
2022:167038, 07.05.2024**

**Bashkëpunëtorja profesionale**

\_\_\_\_\_  
Edona Berisha Kastrati

**Gjyqtari i vetëm gjykues**

\_\_\_\_\_  
Musë Povataj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.